

# Si ta Nisni Procesin e Mbështetjes te Vetja

Hapat	Koha	Kriteret	Ide të Tjera
<b>1- Caktoni një Datë për Seminarin Praktik "Shtegu Im"</b>	Tani	Caktoni një datë në të ardhmen dhe filloni duke ndjekur hapat e tjerë. Rezervoni një 2-orësh për të plotësuar librin e punës "Shtegu Im".	Vendosni një datë dhe orë që do të funksionojë më së miri për anëtarët. Kjo mund të mbahet gjatë Shkollës të së Dielës dhe Priftërisë/Shoqatës së Ndhmës, nëse miratohet nga peshkopi.
<b>2- Thërritni ose Caktoni Specialist dhe Ndërmjetës</b>	5 Javë Përpara Seminarit Praktik	Thërritni ose caktoni një Specialist të Lagjes për Mbështetjen te Vetja dhe ndërmjetës. Anëtarët e këshillit të lagjes mund t'i zënë këto role. Specialistët dhe Ndërmjetësit duhet të ndihmojnë për ndërmjetësimin e Seminarit Praktik.	Një ndërmjetës nuk ka nevojë për njohuri të veçanta për të ndërmjetësuar grupet e Mbështetjes te Vetja. Ata duhet të jenë në gjendje të ndjekin materialet dhe t'i duan pjesëmarrësit. Ata nuk janë për të dhënë mësim, por për t'i ndihmuar anëtarët të marrin pjesë.
<b>3- Porositni Materialet</b>	4 Javë Përpara	Duhet të ketë mjaftueshëm broshura "Shtegu Im drejt Mbështetjes te Vetja" dhe "Themeli Im" për çdo person që pritet të marrë pjesë.	Gjithashtu duhet të ketë në dispozicion kopje të manualeve për çdo grup që pritet (Kërkimi i Vendit Tim të Punës, Arsimim për Punë më të Mirë dhe Nisja dhe Rritja e Biznesit Tim), në mënyrë që grupet të mund të fillojnë menjëherë pas seminarit praktik.
<b>4- Trajtojeni Këshillin e Lagjes</b>	4 Javë Përpara	Kjo mund të bëhet gjatë mbledhjes së këshillit të lagjes. Disa kune duhet të zgjedhin ta bëjnë këtë me shumë njësi së bashku.	Këshillat e Lagjeve janë çelësi drejt suksesit. Këshilli duhet ta kuptojë doktrinën dhe procesin në mënyrë që ata të mund t'i ndihmojnë anëtarët e organizatave të tyre dhe të japin mbështetje.
<b>5- Reklamoheni Seminarin Praktik "Shtegu Im"</b>	3 Javë Përpara	Lajmëroji anëtarët dhe misionarët për datën. Krijoni afishe dhe ftesa.	Mund të jenë në dispozicion materiale standarde të përgatitura nga Shërbimet e Mbështetjes te Vetja.
<b>6- Jepeni Mësim Doktrinën e Mbështetjes te Vetja</b>	3 Javë Përpara	Përdorni mbledhjet e sakramentit dhe mësimet e tjera.	Ndërsa jepet mësim doktrina, Fryma e Shenjtë do t'i prekë zemrat e anëtarëve në mënyrë që ata të dëshirojnë të bëhen të mbështetur te vetja materialisht dhe shpirtërisht dhe të marrin pjesë në Seminarin Praktik "Shtegu Im".
<b>7- Identifikoni dhe Ftoni</b>	2 Javë Përpara	Këshillat e Lagjeve identifikojnë individët dhe veçanërisht i ftojnë ata të marrin pjesë në Seminarin Praktik "Shtegu Im". Kjo përfshin anëtarët aktivë. Shih DeB 84:106.	Këta duhet të përfshijnë misionarët e kthyer, anëtarët e rinj, anëtarët më pak aktivë, përfituesit nga programi i mirëqenies dhe miqtë joanëtarë. Gjithashtu mësuesit e shtëpisë dhe mësueset vizitore e udhëheqësit.
<b>8- Trajtojini Ndërmjetësit</b>	1 Javë Përpara	Siguroni trajnim për ndërmjetësit e caktuar. Mund të ndihmojnë komitetet e kunit për mbështetjen te vetja.	Materialet në internet janë në dispozicion në srs.lds.org, duke përfshirë materialet filmike për trajnim dhe "facilitator guide" ["udhëzuesin për ndërmjetësimin"].
<b>Zhvillojeni Seminarin Praktik "Shtegu Im"</b>	Java e Seminarit Praktik	Fillojeni me mesazhin nga Udhëheqësit e Priftërisë (5 deri në 10 minuta) dhe pastaj ndiqini materialet me saktësi. Në fund ndahuni në Grupe të Mbështetjes te Vetja.	Nëse ndërmjetësit nuk janë caktuar më parë, përzgjidheni dikë në secilin grup që të jetë ndërmjetësi. Nëse anëtarët e ftuar mungojnë në seminarin praktik, ndihmohuni ata më vete që ta përfundojnë seminarin praktik "Shtegu Im" dhe t'i bashkohen një grupi.
<b>Nisni Grupet e Mbështetjes te Vetja</b>	1 Javë Përpara	Grupet e Mbështetjes te Vetja duhet të jenë gati të nisin brenda një jave nga seminari praktik.	Në fund të Seminarit Praktik "Shtegu Im", grupet vendosin datat dhe oraret e takimeve.